

# *Dramë*

## *SHPËRTHIMI I ERRËSIRËS*



*Autori: Afrim Morina*

### **Dramë një aktesh**

#### **Fytyrat**

**Qëndrimi  
Shpëtimi  
Fitorja  
Liria  
Bujari  
Besniku  
Drita  
Shkëndija  
Krimineli  
Xhelati  
Spiuni  
Pobeda  
Slloboda  
Mjeku**

**Udb- ash, gardian, qytetar të moshave të ndryshme, daullexhinj dhe këngëtar.**

### **Paraloja**

**Pamja e parë**

Ambient parku. Në skenë Qëndrimi me uniformë ushtarake, me pushkë në krah, ndërsa plisin e ka futur në rrip të pantallonave. Duket i gëzuar. Endet duke i rënë guralecëve.

**Qëndrimi**

Eh, u afrua kjo ditë që ta gëzojë Fitoren- Fishkëllen.

Hyn Shpëtimi, edhe ky i gëzuar.

## **Shpëtimi**

Hë, Qëndrim, është afër që të realizohet ëndrra?

## **Qëndrim**

Shpëtim, erdhe?...- (Gjithnjë i gëzuar)- Më në fund do ti heqim këto armë nga brezi dhe ti kthehemi ndërtimit të vendit.

## **Shpëtimi**

Ashtu Qëndrim. Erdhi koha që edhe ne të jetojmë si të tjerët. Nuk kalon jeta gjithnjë me armë në krah. Megjithëse ende na paraqiten pengesa që ta gëzojmë Lirin dhe Fitoren.

## **Qëndrimi**

Jam i vetëdijshëm për këtë, por duhet mbledhur forcat për të shkuar gjer në fund. Dasmorë kemi mjaftë, por janë të lodhur dhe të varfër.

## **Shpëtimi**

Por nuk u mungon vullneti.

Në skenë duken dy vajza të reja. Njëra ka të veshur një fustan të gjatë ngjyrë të kuqe, që paksa i shihen këpucët gjithashtu të kuqe. Flokët i ka të lëshuara prapa shpinës dhe të rregulluara me një kordele të kuqe. Tjetra sikurse shoqja e saj, por ngjyrën e fustanit, të këpucëve dhe të kordeles i ka të bardha. Ato me hap të ngadalshëm i afrohen djemve.

## **Qëndrimi**

Ja ku duken. Vijnë drejtë nesh. Duhet t'i mbledhim forcat dhe të shkojmë drejtë tyre.

## **Shpëtimi**

Të shkojmë!

Fillojnë të afrohen të dy qiftet. Në prapaskenë dëgjohen të shtëna armësh, kalibrave të ndryshëm. I pjekin armët nga krahët dhe marrin pozicion mbrojtës. Shpinë për shpinë shkojnë drejtë vajzave. Edhe ato kapën për njëra tjetrën dhe fillojnë të ecin në drejtim të djemve. Krismat e armëve shpeshtohen. Dëgjohen sirena alarmi. Dritat në skenë fillojnë të dobësohen. Dëgjohej edhe gjëmimi i armëve artilerie dhe zhurma e aeroplanëve. Gjatë tërë kësaj kohe nga prapaskena vijnë

edhe zëra njerëzish, të gjinive dhe moshave të ndryshme.

Qëndrim!  
Shpëtim!  
Fitore!  
Liri!  
Në armë për ti mbrojtur nuset tona!  
Bashkohuni që të shkojmë drejtë tyre!  
Nuk lejojmë që të na i marrin ato!

## **Zëri i altoparlantit**

Qetësohuni! Do të përdorim gjithë arsenalin ushtarak dhe nuk do të gëzoni Fitoren dhe Lirinë! Banditët të zihen dhe të dënohen me pushkatim!

Oh!  
Bir!  
Nënë!  
Shkova me djemtë!- Zë mashkulli.  
Shko! Fëmijët do ti ruaj unë!- Zë femre.

Në skenë dy qifte fillojnë ti afrohen njëri tjetrit. Skena gati është errësuar.

## **Qëndrimi**

Shpëtim, e gëzofsh Lirinë! Vetëm përpara!

## **Shpëtimi**

Qëndrim e gëzofsh Fitoren! Përpara!

Skena errësohet në tërësi. Zhurma fillon të pakësohet, më parë nga armët e rënda, zhurma e aeroplanëve, sirenat e alarmit. Dikur nuk dëgjohen as zërat e njerëzve dhe krismat e armëve.

## **Pamja e dytë**

Ndezën dritat. Në pjesën e fundme të skenës duken nga tri qeli burgu për meshkuj dhe femra. Te njëra pjesë është një gardian, ndërsa te pjesa tjetër një gardiane. Në paraskenë, në të dy qoshet është nga një qeli. Në të djathtë është Fitorja po me atë veshje dhe pranë saj një gardiane. Në të majtë është Liria, gjithashtu me të njëjtën veshje dhe një gardiane pranë saj. Në skenë, në mes të dy pjesëve të improvizuara si burgje, gjinden tavolina, dy karrige, shufra gome, gajtan reshou, tel, e tjera rekuizita për tortura.

Krimineli hyn i qet. Ulet në karrige. Shpërthekon pullën te fyti dhe çliron kravatën. Ngrihet, heq setrën dhe e vë në varëse. Përvjel mëngët e këmishës. Ndez një cigare dhe e nxjerr një fasikël nga sirtari i tavolinës. I veçon disa letra. Efekti i dritave është i përqendruar në të. Në të djathtë janë të burgosur tre djem të ri, e në

anën tjetër tri vajza të reja. I mëshon me dorë tavolinës. Në skenë hynë xhelati.

### **Xhelati**

Urdhëro shoku Shef!

### **Krimineli**

Ma sillni Bujarin!

### **Xhelati**

Si urdhëro shoku Shef!- Del.- Roje!

### **Gardianit i parë**

Urdhëroni shoku Shef!

### **Xhelatit**

Na e sillni të burgosurin e qelisë numër një!

### **Gardiani i parë**

Si urdhëroni shoku Shef!- E hap derën e qelisë- Del jashtë! Do të pegllatin!  
Hë!- ia vë prangat në duar- Përpara! Deshe të bëhesh krushk për Fitoren dhe  
Lirinë! Tash nga këtu do të dalësh vetëm i vdekur!

### **Bujari**

Të dyja nuset do ti marrim!

### **Gardiani i parë**

Përpara bandit!- E qet nga skena dhe kthehet në vendin e punës.

Në skenë Bujarin e sjellë Gardiani i dytë bashkë me Xhelatin. Po nga ajo  
anë hynë edhe tre civilë. Në fytyrën e Bujarit shihen shenjat e torturave dhe  
pagjumësia.

### **Krimineli**

Ulu!... Ke menduar?!

### **Bujari**

Nuk kam çka mendoj.

### **Krimineli**

Kush të thirri për krushk që ta sjellësh Fitoren dhe Lirinë!?

**Bujari**

Askush. Vet e pash të rrugës këtë.

**Krimineli**

Si duket nuk të paskan përpunuar mjaft?!

Shërbëtori i sjell kafe për ta dhe del. Kafet i shpërndajnë ndërmjet vete. Xhelati e pi me të shpejtë, sikur nuk i pritet.

**Krimineli**

Fol!

**Bujari**

Hesht

**Krimineli**

Bir bushtre, fol!

**Bujari**

Hesht

**Krimineli**

Do ta zhdukim gjithë sojin tënd!... Trego për çfarë të pyeta!

**Bujari**

Hesht

**Xhelati**

Fol!- Fillon ti sjell me shufër gome kokës dhe shpatullave. Bujari bie nga karriga.

**Bujari**

Gjakpirës! Të poshtër! Xhelat!

## **Spiuni**

Ta ka mësuar nofkën.

## **Xhelati**

Do tua marr shpirtin të gjithë këtyre!- Nxjerë nga xhepi një çelës të vogël dhe ia heq prangat.- Tash do të këndosh!- Ngiten edhe të tjerët dhe e zhveshin shok e përpjetë lakuriq. E shtrinë barkas dhe dikush e mban për duar, dikush për këmbë, dikush kokën, e Xhelati fillon nga qafa ta godas me shufër gome, duke shkuar gjer te shputat e këmbëve dy tri herë. Bujari herë pas here lëshon ndonjë rënkim të përzier me ofshamë dhe sharje.

## **Bujari**

Kriminel!...

## **Krimineli**

Po, tash unë!- E kap gajtanin e reshosë dhe e sulmon si bishë. Bujarit i bie të fikët. I qesin ujë fytyrës. Kthjellohet. E ulin në karrige.

## **Xhelati**

Fol, farë e keqe!- në të folur diktohet lodhja- Kush të ftoi për krushk!?

## **Bujari**

Askush. Vet e pash të arsyeshme.

## **Krimineli**

Vet e ke parë të arsyeshme... Mirë, kënd e ke ftuar?

## **Bujari**

Askënd.

## **Spiuni**

Kush ishte ai, kur i the gjer në vdekje për Fitore dhe Liri?

## **Bujari**

Kështu mundohesh të lëpish ndonjë asht që ta gjuajnë armiqtë?

## **Spiuni**

E godet shuplakë fytyrës.- Juve ua ka pi sorra mëndtë. Këtë e bëjë se e di, që tërë ditën jeni gabim.

## **Bujari**

Edhe nga ana jonë do të shpërblehesh me plumb!

## **Xhelati**

Gjilpërën!

Njëri nga të pranishmit ia jep gjilpërën. Të tjerët e kapin Bujarin. Dy prej tyre ia kapin njëren dorë. Xhelati ia kap gishtin e madh dhe fillon gjilpërën ngadalë t'ia shti mes thoit e mishit. Bujari djersitet dhe bënë përpjekje për tu liruar. Ky torturim i xhelatit arrin deri në gishtin e vogël. Bujarit ndërkohë i ka rënë të fikët. Gjatë gjithë kësaj kohe, sa zgjat tortura, Krimineli është kërrusur dhe me dorë i kap mjekrën Bujarit duke i bërtit.

## **Krimineli**

Fol!

Bujarit pasi t'ia nxjerrin kllapinë, e ulin në karrige.

## **Krimineli**

Mirë. Po të lëmë të mendosh. Përcille... Sille tjetrin.- I zgjat njërit një letër.

Bujari bashkë me një gardian i afrohen qelisë, pasi të ketë dalë dhe hyrë në skenë. Mezi e mbajnë këmbët. Posa hyn në qeli ngadalë lëshohet në dysheme. E nxjerrin të burgosurin e qelisë numër dy. E dërgojnë në zyrën e hetuesisë. Posa të hynë menjëherë e sulmojnë me grushte dhe shqelma. Rrëzohet. Njëri ia zgjidhë prangat.

## **Krimineli**

Ulu!... Je menduar mjaft!?

## **Agimi**

Nuk kam pse të mendohem.

## **Krimineli**

Me kokëfortësi këtu nuk shkon.

## **Agimi**

Mund të më merrni vetëm jetën.

## **Krimineli**

Nëse nuk pranon edhe jetën nuk e ke të gjatë. Do ta marrim dalë ngadalë shpirtin!

## **Agimi**

Çka po pritni? Prej kriminelëve dhe xhelatëve nuk pres diçka tjetër.

Krimineli dhe Xhelati fillojnë ta qëllojnë njëri me shufër gome e tjetri me gajtan reshou. E rrëzojnë nga karrigia. Edhe të tjerët e godasin me shqelma. Nga hunda dhe goja fillon ti shkoj gjaku...

## **Krimineli**

Fol!

## **Agimi**

Hesht.

## **Krimineli**

Vetëm trego kush të ndihmoi në botimin e shkrimeve tua dhe i lirë je?!

## **Agimi**

Krushqit!

## **Krimineli**

Njërin nga ata?

## **Agimi**

Do ti njohësh kur të fillon të japësh llogari para tyre.

## **Xhelati**

Asnjë nuk kam për ta lënë të gjallë nga fara juaj!

## **Agimi**

I vogël je! Kanë provuar edhe shumë të tjerë para jush...

Ia ndërpre në fjalën duke e rrahur. E ulin në karrige dhe e zhveshin shok e përpjetë.

## **Xhelati**

Qëllojeni vet!- (Ndërkohë njëri del. Pas pak kohe hynë me një tas në dorë)- Fol sa nuk kam filluar!

## **Agimi**

Juve nuk u ka mbetur asgjë pos shtazores.

## **Xhelati**

Mbajeni!- Pasi të tjerët e mbërthejnë kush ku mundët, e merr një ve dhe ia fut nën sqetullën e majtë, pastaj tjetrën nën sqetullën e djathtë. U jep shenjë që krahët t'i lëshojnë teposhtë. Vezët diktohen se janë aq të nxehta nga avulli që lëshojnë dhe sa që Xhelati mezi i mban në dorë. Agimi bënë përpjekje të lirohet. Por pa sukses. I bie të fikët. Ia heqin vezët dhe i qesin ujë fytyrës e trupit. Agimi kthjellohet.

## **Krimineli**

Do të tregosh!?

## **Agimi**

Kurrë!- Me zë të shterur.

## **Krimineli**

Vazhdoni!

Xhelati ngitet dhe u jep shenjë të tjerëve t'i ndihmojnë. Të dy këmbët e Agimit fillojnë ti mbajnë të tjerët. Xhelati merr disa qirinjë dhe ndërmjet secilit gisht të këmbëve ia fut nga një qiri të cilët i ndez. Merr edhe dy qirinj të tjerë, i ndez dhe ia ofron shuplakave të këmbëve duke i endur. Agim rënkon nga dhimbjet, por kot. Bënë përpjekje për tu liruar. Pas pak nuk dëgjohet zëri tij dhe trupi i rrëshqet nga karrigia. E ndërpre në torturën. I qesin ujë fytyrë dhe këmbëve. Kthjellohet.

## **Krimineli**

Fol!

## **Agimi**

Bënë përpjekje të flladitet, por nuk ka forcë. Nga gjestet shihet se i përbuzë

torturat.

## **Krimineli**

Ja letër dhe laps, shkruaj! Nëse tregon të dërgojmë menjëherë te mjeku dhe askush më nuk do të pyes për asgjë.- I afron letër dhe laps.

Agimi merr letrën dhe lapsin. Shkruan dhe me hidhërim ia gjuan Kriminelit.

## **Krimineli**

Lexon me zë.- Kriminelët, xhelatët, tradhtarët, spiunët dhe këlyshët e tyre janë të dënuar në emër të dasmorëve me vdekje! Rroftë Fitorja! Rroftë Liria!...- Ia gjuan letrën për fytyrë- Tallësh me ne?!- Njëri ia sjell një tel dhe një palë dara. Gjersa të tjerët e mbajnë, krimineli ia lidhë rreth kokës telin dhe me dara fillon t'ia shtrëngo. Agimi bën përpjekje të lirohet. Dikur i varet tërë trupi. Mundohen ta mbajnë, por ai tashmë është i pa jetë. Të gjithë shtangen. I matin pulsën. Veshin e vë në zemër të Agimit, për të dëgjuar të rrahurat e saj. Spiuni e nxjerr pasqyrën dhe ia ofron te hundët.

## **Spiuni**

Mirë ia ke bërë dreqit!

## **Krimineli**

Krimineli u bënë shenjë të gjithëve që të ulen. Merr telefonin dhe sjellë numra.- Alo!... Dërgona mjekun me urgjencë!... Po, po. Urgjent!

Bie heshtja. Pas pak hyn mjeku me një çantë.

## **Mjeku**

Mirë dita!

## **Të tjerët**

Mirë dita!

## **Mjeku**

Për këtë?

## **Krimineli**

Po.

## **Mjeku**

- Pasi e kontrollon.- Ka vdekur- Ulet në një karrige.

### **Krimineli**

Duhet përgatitur dokumentin përkatës, se është vrarë nga plumbat.

### **Mjeku**

Po...!- Shikon i habitur.

### **Krimineli**

Ashtu edhe do të duket!

### **Mjeku**

Në rregull.

### **Krimineli**

Të mos humbim kohë. Unë do të bëj raportin... Ti jepen disa plumba. Agim Drini është vrarë në kufi dhe... U morën vesh?- Të gjithë ngritën. E qesin kufomën e Agimit jashtë. Bashkë me kufomën dalin të gjithë.

## **Pamja e tretë**

Efekti i dritave bie në qeli të meshkujve. Bujari troket në murin e qelisë fqinje. E përsërit disa herë por pa përgjigje.

Dritat bien në paraskenë, në qelin e Fitores. Te dera e saj afrohet një gardiane dhe e sjellë një femër me veshje sikur të saj, por shihet se është e ndotur. Flokët i ka të shprishura dhe e shtyrë në moshë. Kordelet iu kanë varur në fund të ballit. Kur të hapet dera Fitorja e shikon me përbuzje.

### **Fitorja**

Kush je ti?!

### **Pobeda**

Motra jote më e madhja.

### **Fitorja**

Motër?!... Për që je shtrigë po dihet, e sa për motër kurrë!

### **Gardiania e parë**

Kjo është Pobeda! Kujdes çfarë po flet!

### **Fitorja**

Ha, ha, ha! Edhe Pobedën e juaj qenka mplakur... qenka ndotur mu si shtrigat!

### **Pobeda**

Nuk të hidhërohet motra ty. Veç duhet të bindesh, se më mirë është të bëhesh me ne, se të jesh me ato egërsirat.

### **Fitorja**

Pamja e jote jep për të kuptuar se jeton në mesin e egërsirave!

### **Gardiania e parë**

Mbylle gojën!

### **Fitorja**

Largoma këtë shtrigë nga këtu! Unë i përkas vetëm Qëndrimit!

### **Pobeda**

Një ditë do të bindesh se e ke gabim!

### **Fitorja**

Ha, ha, ha! Bushtë! Nuk do të mposhtemi kurrë, ik nga këtu!

### **Pobeda**

Do të shihemi më vonë.

### **Fitorja**

Atëherë do të jesh edhe më e fëlliqur se tash!

Gardiania e parë e mbyll derën me rrëmbim në shenjë nervoze. Efekti i dritave bie në qelinë e Lirisë. Pranë derës është një femër e shtyrë në moshë, po me atë veshje, e ndyrë, flokë të shprishura dhe kordelja në mënyrë të shkujdesur,

bashkë me ballukët e ballit, i varet në qafë. Gardiania e dytë hap derën e qelisë.

**Liria**

Kush është kjo?

**Sloboda**

Motra jote, më e madhja.

**Liria**

Nuk kam dëgjuar të kem ndonjë motër shtrigë?!

**Gardiania e dytë**

Mbylle gojën!

**Sloboda**

Nga rinia e ke këtë energji. Duhet ta kuptosh më, sepse ti nuk je për njerëz të egjër. Ti në këtë botë ke ardhur vetëm për fisin tonë.

**Liria**

Fis barbarësh!

**Gardiania e dytë**

Shumë po ju fyen Sloboda?

**Sloboda**

Duhet të heqësh dorë nga Shpëtimi. Vetëm nga dhembshuria për ty kam ardhur në këtë gjendje.

**Liria**

Në këtë gjendje të pistë ke ardhur nga se je shpirtzezë. Vetëm kur të kupton të vërtetën do të kesh fytyrë të dalësh në mesin e shoqeve! Unë jam për shpëtimin dhe ai është për mua!

**Sloboda**

Do të pendohesh, por do të jetë vonë!

**Liria**

Hiqma sysh!

Sllloboda i jep shenjë Gardianes të mbyll derën dhe largohet.

### **Pamja e katërt**

Efektet e dritave bien në skenë. Krimineli është i ulur. Ndez një cigare dhe mëshon tavolinës me dorë. Hyn Xhelati.

### **Krimineli**

Foli?

### **Xhelati**

Jo.

### **Krimineli**

Sillmani këtu!

Xhelati del. Pas pak hyn me një vajzë. E ulë në karrige.

### **Krimineli**

Drita?

### **Drita**

Po.

### **Krimineli**

Ne kemi të dhëna se ti iu ke ndihmuar në përgatitje rreth dasmës dhe caktuar krushke. Duhet të na tregosh se kush të ftoi për dasmë dhe kush të caktoi për krushke?

### **Drita**

Në dasmë më ka ftuar Liria, ndërsa për krushke më ka ftuar Fitorja.

### **Krimineli**

Bushtër!- I mëshon shuplakë. Ia kap dorën dhe me cigare ia djeg. Ajo e largon dorën. Xhelati e kap cigaren e Kriminelit dhe ia djeg faqen.- Prishja krejt fytyrën!

### **Drita**

Sa më shumë që ju mundoheni të më shëmtoni, aq më e bukur do të dukem si krushke.

### **Krimineli**

Të gjithë dasmorët kemi për ti rrjepur të gjallë. Do ta zhdukim farën tuaj të ndyrë!

### **Drita**

Veç fyerjeve dhe sadizmit nuk u ka mbetur gjë tjetër. Ju ka humbur arsyeja dhe jeni shndërruar në robotë. Sa për të na humbur farën jeni të fundit që mundoheni në histori.

### **Xhelati**

Mbylle!- Me grusht i bie në kokë. E rrëzon në dysHEME dhe fillon ta shqelmoj. Drita mblidhet tutël duke shtrënguar trupin.

### **Krimineli**

Fol kudër!

### **Drita**

Heshtë.

### **Krimineli**

Kam për të rrjepur për së gjalli!- Afrohet dhe bashkë me Xhelatin e ulin në karrige. E afrojnë edhe një karrige tjetër.- Shtriji këmbët!

### **Drita**

Nuk lëviz.

### **Krimineli**

Shtriji këmbët kur të them!

### **Drita**

Nuk lëviz.

Krimineli bashkë me Xhelatin ia kapin këmbët për t'ia qitur mbi karrige. Ajo kundërshton. Hyn edhe një tjetër, nga ata që kanë marrë pjesë në torturat e dy të burgosurve. Njeri e kap për flokësh. Xhelati dhe Kriminel ia shtrijnë këmbët mbi karrige. Xhelati ulet në prehrin e saj dhe ia shtrëngon këmbët. Krimineli e merr kërbacin dhe pasi t'ia ketë hequr këpucët dhe çorapet, fillon ta godasë. Qëllon si i çartur dhe shihen shenjat e lodhjes në fytyrën e tij. Përpyekjet e Dritës për tu liruar janë të kota.

## **Drita**

Kriminel!... Fitorja është e jona! Rroftë Liria! Fa...

Xhelati e qëllon me bërryl në gojë, ndërsa Krimineli me shuplakë i bie fytyrës. Nga hundët e Dritës del gjaku. Dikur ndalen. Ajo nga karriga bie në dysheme. I qesin ujë fytyrës. Ajo lëviz kokën. Mbledh forcë dhe pështynë në drejtim të Xhelatit. Ai e qëllon sa mundet në mjekër me shqelma. Drita shtrihet sa gjerë gjatë. Krimineli afrohet dhe e kap për mjekre. Koka e saj lëviz lirshëm.

## **Krimineli**

Ia ke thyer mjekrën! Ta dërgojmë urgjentisht te mjeku. Arsyetoni lëndimin!- të dytë e nxjerrin nga skena.

Në skenë fikën dritat. Në paraskenë dëgjohet zhurmë. Brohoritje, por zërat nuk dallohen. Dëgjoen sirena të alarmit. Të shtëna armësh. Disa hije duken në skenë.

## **Zëri i Kriminelit**

Të merren të gjitha masat, për shpërndarje e dasmorëve! Secili në detyrën e vet!

Përsëri duken hijet të lëvizin në skenë. Efekti i dritës bie në zyrën e hetuesit. Hyn Krimineli i nervozuar. Heq setrën, e gjuan në varëse. Pas tij hyn Xhelati, Spiuni dhe dy të tjerë duke e tërhequr një djalë të ri zhargas. Djaloshi i shihet gjaku në fytyrë. E gjuajnë para këmbëve të kriminelit.

## **Krimineli**

Si quhet?

## **Spiuni**

Besnik Qarri.

## **Krimineli**

E njeh?

**Spiuni**

Po. Të kam treguar për këtë. Dosjen e ka të hapur që kur ka qenë nxënës.

**Krimineli**

Ka qenë i dënuar më parë?

**Spiuni**

Po.

**Krimineli**

Ngrehu dhe ulu në karrige!

Besniku ngritët me mundim dhe ulet.

**Krimineli**

Ti paske përvojë me ne, prandaj mos e mundo veten.

**Besniku**

Hesht.

**Krimineli**

Mos u bë kokëfortë. Ne kemi rekuizita që të bëjnë të flasësh.

**Besniku**

Hesht.

**Krimineli**

Mirë... Pse keni ngulur këmbë për të dërguar krushq për ta sjellë Fitoren dhe Lirinë, kur këto i keni, madje më të mira se sa i meritoni?!

**Besniku**

Ne nuk kërkojmë asgjë më tepër se sa na takojnë. Me këto fraza mund ti gënjeni të tjerët.

**Krimineli**

Nuk jeni të denjë për më tepër. Madje ne jemi tepër human që sillemi kështu me ju. Ju po e keqpërdorni njerëzinë tonë.

### **Besniku**

Sa për ato, ne jemi më të denjë se ju për ti gëzuar. Ndërsa njerëzinë e juaj e kemi provuar me shekuj. Njerëzimi i juaj mund të përmbliidhet me një tog fjalësh, sadifashizëm.

### **Krimineli**

Kush të ka mësuar të flasësh kështu!?

### **Besniku**

Krimet e juaja.

### **Krimineli**

Ne jemi fajtor që nuk ua kemi zhdukur farën e juaj!

### **Besniku**

Për këtë nuk keni lënë mjet pa përdor, madje edhe në koordinim me shtetet tjera.

### **Krimineli**

E sheh se sa but ne sillemi me ty, edhe pse ti na fyen?

### **Besniku**

E kam provuar butësinë e juaj.

### **Krimineli**

Ne e dimë edhe një gjuhë tjetër komunikimi.

### **Besniku**

E kam provuar. Edhe pse kanë kaluar disa vite, gjurmët e asaj gjuhe i kam ende në trup.

### **Krimineli**

Do të flasësh?!

## **Besniku**

Veç jemi duke biseduar.

## **Krimineli**

Atëherë fol, kush të caktoi për krushk?

## **Besniku**

Vet.

## **Krimineli**

Je i bindur se do të ngadhënjeni?

## **Besniku**

Asnjë dasmë nuk ka mbetur pa nuse, as e jona nuk do të jetë. Varet krejt nga ju se si do ta marrim.

## **Krimineli**

Xhelat, vazhdo të flasësh me këtë!

Xhelati nuk pret as një as dy, por i mëshon me shqelma në bark. Si shtazë e egër sjell me çka ti vjen për ndoresh. Atij i ndihmon Spiuni dhe dy të tjerët, duke thirrur si të çartur herë njëri herë tjetri.

Fol!

Fol se të mbyta!

Shpirtin kam me ta nxjerr me thonj, fol!

Besniku hesht dhe sa mundet mbrohet. Dikur i bie të fikët dhe trupi i tij bie për dysheme. Këta i ndalin goditjet. I qesin ujë fytyrës. Besniku vjen në vete.

## **Krimineli**

Fol!

## **Besniku**

Së shpejti do të ndërrohen pozicionet tona.

## **Spiuni**

Djalë i mirë, ne kemi nderin që jemi me këta.

## **Besniku**

Do të shpërblehesh për këtë nder me plumb!

## **Spiuni**

Do të bindesh se ne kemi më shumë të drejtë. Por juve ua ka pi sorra mëndtë.

## **Besniku**

E ty do të përpij vdekja!

## **Spiuni**

E godet me grusht fytyrës.- Ne përpiqemi për të mirë, e këta shihe si ta kthejnë!

## **Krimineli**

Mjaft të ledhatuam! Tash do të na flasësh për të gjitha! Kush të ftoi për krushk, kë e ke ftuar, kur dhe ku!?

## **Besniku**

Më ka ftuar Fitorja dhe Liria! Unë nuk e kam ftuar as kë.

## **Krimineli**

Mos të humbim kohë me këtë kokëfortësinë tënde! Përgjigju në pyetje!

## **Besniku**

Jam mish dhe ashti i këtij trolli!

## **Krimineli**

E ne?!

## **Besniku**

Gjemba të thatë të zbritur nga Karpatet!

Xhelati fillon ta qëllojë me gajtan reshou, Besniku mbrohet me duar. Pastaj të tjerët e mbajnë. E ky ia thyen eshtrat e duarve. Besnikut i bie të fikët. I qesin ujë

fytyrës dhe ia nxjerrin kllapinë. Duart i mbesin të ngrira.

### **Krimineli**

Fol!

### **Besniku**

Hesht.

### **Krimineli**

Fol se ta nxora shpirtin!

### **Besniku**

Me kriminelë dhe xhelat nuk flas.- Duke i shtrënguar dhëmbët nga dhimbja, mezi i del zëri.

### **Xhelati**

Fol!... Fol, sa nuk të kam bërë copë, copë!- I afrohet dhe e kap për flokësh.

### **Besniku**

Hesht. Duart nuk mund ti lëviz edhe pse shihet përpjekja e tij.

### **Xhelati**

Fol kopil!- E ngreh për flokë.

Besniku ngrihet me të shpejtë, i mëshon me kokë hundëve. Xhelati bie në dysheme, ky fillon ta shqelmojë. Ngritën të gjithë dhe sulen kundër Besnikut. Ky fillon të sjelli me këmbë edhe në drejtim të tyre. Spiuni e nxjerr revolen dhe me dorëzën e saj e godet prapa koke. Besniku rrëzohet në dysheme. Të gjithë e këqyrin Spiunin dhe ulën në karrige. Xhelati mat pulsën. Me kokë jep shenjë se ka vdekur.

### **Krimineli**

Gjuaje për dritare!... Vetëvrasje!

E heqin kufomën e Besnikut nga skena. Nga prapaskena dëgjojnë zëra. Errësohet skena.

### **Zëri i parë mashkulli**

Vëni re! Vëni re! Kërkojmë nga dasmorët që të shpërndahen, të shkojnë të gjithë nëpër shtëpi të veta dhe ta lënë dasmën. Ne do të merrem me të!

### **Zëri i dytë mashkulli**

Dasma është e jona vëllezër dhe motra! Askush nuk ka të drejtë të na pengojë në marrjen e nuses! Mos i besoni tradhtarëve!

### **Zëri i parë femre**

Frikën ta mbysim, vëllezër dhe motra! Guximi dhe Qëndrimi na sjellin Fitoren dhe Lirinë!

### **Zëri i parë mashkulli**

Vëni re! Vëni re! Kërkojmë që të shpërndaheni!- Zëri duket sikur i përsërit dikujt në vesh- Të futën në rreth! Të gjitha mjetet të përdoren kundër kësaj fare të mallkuar!

### **Zëri i tretë mashkulli**

- I përgjigjet zërit të parë mashkulli- Nga qendra janë duke ardhur ndihma. Janë paralajmëruar edhe aeroplanë e helikopterë të vijnë.

### **Zëri dytë mashkulli**

Kujdes, ne vet jemi tubuar për dasmë, e jo të sillemi me arrogancë!

### **Zërat e të dy gjinive**

Ashtu është! Rroftë Fitorja! Rroftë Liria!

Dëgjoen alarmet, zhurma e tankeve, aeroplanëve, helikopterëve...

### **Zëri i parë mashkulli**

Sulm!

Dëgjoen zëra kushtrimi, të ndjekësve, zhurma e teknikës ushtarake, krisma armësh etj. Pas pak zërat ndërpritën. Efekti i zhurmës bie. Ndriçohet zyra e hetuesisë. Në skenë Xhelati dhe Spiuni janë duke e rrahur një vajzë. Hyn Krimineli me dy të tjerë. E zhvesh setrën, njëri nga ata ia merr dhe e vë në varëse.

### **Krimineli**

Foli?

### **Xhelati**

Jo.

### **Krimineli**

I afrohet.- Si të quajnë?!

Heshtje.

## **Krimineli**

Kush është kjo?!

## **Spiuni**

Shkëndije Rrapi

## **Krimineli**

E njihni?

## **Spiuni**

E njoh. Kjo duhet të flas patjetër. Krushke është.

## **Krimineli**

Atëherë, çfarë prisni?

## **Xhelati**

Të përdorim elektroshokun?

## **Krimineli**

Edhe dreqin përdore aman, vetëm të flas! Heshtja e këtyre më bënë të çmendëm!

Xhelati i mëshon me elektroshok në kraharor Shkëndisë. Shkëndija dridhet nga efekti i rrymës.

## **Krimineli**

Ndërprerje. Ule në karrige... Fol, çfarë roli ke pasur në dasmë?

## **Shkëndija**

Krushke.

## **Krimineli**

Kush të caktoi?

## **Shkëndija**

Me vullnet timin.

## **Spiuni**

Është në rrethin e ngushtë të krushkave.

## **Krimineli**

Është e vërtetë?

## **Shkëndija**

E vërtetë.

## **Krimineli**

Të tjerët kush janë?

## **Shkëndija**

Të gjithë, i madh e i vogël dhe këtë radhë nuk kthehem pa nuset!

## **Krimineli**

Gjersa do të jetë fisi jonë këtu, ju kurrë nuk do ti gëzoni nuset!

## **Shkëndija**

Madje së shpejti!

Xhelati i mëshon me shufër gome gjoksit dhe kokës. Ajo përpiqet të mbrohet dhe rrëzohet nga karrigia.

## **Krimineli**

Elektroshokun!

Xhelati e merr dhe ia mëshon Shkëndijës. Ajo fillon të dridhet. Tash zgjat më shumë se herën e parë. Nga prapaskena përsëri vijnë zërat.

## **Krimineli**

Në qeli!

Xhelati e heq elektroshokun. Dy vet e kapin për krihesh dhe zvarrë e nxjerrin nga skena. Te qelitë e merr një gardiane dhe e fut brenda. Nga qelia numër një, një vajzë troket në mur të saj. Shkëndija është e humbur, nuk përgjigjet edhe

pse e trokitura përsëritet. Skena errësohet në tërësi. Asgjë nuk shihet as në paraskenë.

Dëgjojen tupanë dhe zëra të gëzuar. Ndriçohet scena. Është ajo që ka qenë në paralojë. Hynë disa të rinj. Në ballë të tyre janë Qëndrimi dhe Shpëtimi, ndërsa në mes të tyre duket Fitorja. Pas tyre turma e moshave dhe gjinive të ndryshme. Hynë edhe muzikantët. Nga ana e kundërt duket edhe një turmë tjetër të rinjsh meshkuj dhe femra. Në ballë të tyre Liria. Në skenë fillon të luhet vallja e “ Shqiponjave “ dhe gjersa këta janë duke vallëzuar artistët i afrohen skajit të tribunës. Ndalet vallja, në mes të tyre ulet këngëtari dhe me çifteli këndon “ Tetëdhjetë vjet vizitë në grila “:

Tetëdhjetë vjet vizitë në grila  
Copa, copa tuj pa fytyra  
Më të dashurit që i ka zemra  
Pa pas kohë të pyesësh për emra  
    Nëpër burgje të sllavizmit  
    Kaluan gjyshërit, prindërit, nipërit  
    Që të shohim Shqipërinë e lirë  
    Të mallëngjyer prindërit për fëmijë  
Koha matej me vizitë  
Kush do të vjen me të pa atë ditë  
Vijnë të dashurit me u taku- e  
Gardianët rrinë duke përgju- e  
    Nuk të lënë me u përshëndet  
    Veç me fjalë jepet gajret  
    Nëpër grila kalon shikimi  
    Për ndokënd kur jepet ngushëllimi  
Vizitorët shkojnë një nga një  
Me buzëqeshje pa bërë zë  
Të burgosurit qëllimi i forcon  
Duke pritur lirinë të agon  
    Tetëdhjetë vjet vizitë në grila  
    Copa, copa tujë pa fytyra  
    Më të dashurit që i ka zemra  
    Pa pas kohë të pyesësh për emra.

## **Fund**

**13.06.1993.**

**Burgu i Qarkut, Prizren**